




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D /DPK
Dep.	01-2837/hy
Dep.	
Nr. i fad.	
Broj stranica	02
Nr. pages	
Data	11.08.2014
Datum	
Date	
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 05.08.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-1694-14 për z.Xhevrat Bekteshi – Auditor i brendshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për shkak se është shmangur dhe parandaluar situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-1694-14, për Zyrtarin e lartë, z.Xhevrat Bekteshi – Auditor i brendshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe njëkohësisht person i autorizuar në disa biznese private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligi Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Xhevrat Bekteshi fillimisht është njoftuar nga Agjencia kundër Korrupsionit me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Bekteshi është deklaruar se biznesi në fjalë është pasiv dhe se ai do të nisë procedurën për shuarjen vullnetare të tij, për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z.Bekteshi, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar shkresat zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi bizneset" (DPK-03-2781-14) në të cilën shihet se biznesi privat, "Erjoni" DPT., është shuar në mënyrë vullnetare.

Z.Bekteshi me ketë veprim ka parandaluar situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik, dhe tanj ai, ushtron vetëm funksionin e tij zyrtar si Auditor i brendshëm në Ministrinë e Punëve të brendshme.

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrتari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znej. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znej. (zyrtari ndihmës)



Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit